



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Nr. 953/1prot.

Tiranë, 4 Qershor, 2025

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI:

Shërbim konsulence për “Hartëzimin e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor dhe krijimin e Regjistrit Kombëtar”.

Vendndodhja:	Tiranë, SHQIPËRI
Afati i aplikimit:	18 Qershor, 2025 (16.00)
Tipi i kontratës:	Kontratë individuale shërbimi
Gjuha e kërkuar:	Shqip & English
Koha e shërbimit:	25 ditë pune
Ref no.	PA-25.06.18.1

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), partner në projektin e financuar nga BE nëpërmjet programit Horizon Europe “POLICY ANSWERS”, është përgjegjëse për realizimin e disa detyrave që përfshihen në “Paketës së punës nr. 3, Ndertimi i kapaciteteve dhe mbështetja e zbatimit të agjendes së ballkanit perendimor”. Në këtë kuadër AKKSHI kërkon të realizojë “Hartëzimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor dhe hartimin e metodologjisë për krijimin e regjistrit kombëtar të infrastrukturës kërkimore”. Për këtë qëllim AKKSHI shpall thirrjen për shprehje interesi për **3 ekspertë kombëtarë** për mbështetjen e procesit të hartimit të një dokumentit: **“Hartëzimi i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor dhe krijimi i Regjistrit Kombëtar”**.

1. Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i kësaj detyre është të hartojë, vlerësojë dhe dokumentojë në mënyrë gjithëpërfshirëse Infrastrukturën Kombëtare të Kërkimit (IKK) në Institucionet e Arsimit të Lartë shqiptar (IAL) dhe të rrisë aksesin për studiuesit dhe novatorët përmes një platforme të dedikuar online.

1. Detyrat kryesore përfshijnë:

- Analizën e dokumentacionit kombëtar dhe ndërkombëtar (BE), përkatës;
- Intervistimin e aktorëve kyç të sistemit të kërkimit;
- Hartimin e metodologjisë për krijimin e regjistrit (inventarit) të infrastrukturës së kërkimit shkencor
- Vlerësimin e infrastrukturës kërkimore në Shqipëri (në IAL, Institutet e kërkimit shkencor, institucione të tjera);

- Ngritja e kapaciteteve të IAL për popullimin e regjistrit dhe krijimin e një baze të dhënash kombëtare për infrastrukturën e kerkimit.
- Hartimi i raportit përfundimtar, një dokument analitik me rekomandime për përdorimin me efikasitet dhe të hapur të infrastrukturës shkencore kombëtare.

2. Periudha e angazhimit:

25 Qershor – 25 Nëntor 2025

3. Afati i aplikimit:

Thirrja mbyllet më **18 qershor 2025 Ora 16:00**.

4. Mënyra e aplikimit:

Kandidatët do të përzgjidhen në përputhje me metodën e “Perzgjedhjes individuale të konsulentit”.

Aplikantët duhet të dorëzojnë në AKKSHI, dokumentet e të mëposhtme në dy gjuhë (Shqip dhe English) të organzuara në dy dosje:

Dosja 1:

1. **Letër motivimi** në shqip dhe anglisht ku të shpjegohet vizioni për këtë ekspertizë si dhe eksperiencat e mëparshme
2. **Një metodologji** të organizimit të punës dhe instrumentat që do të përdoren për të arritur objektivat dhe afatet e realizimit të detyrës; Detyrat specifike për çdo Expert do të gjenden të detajuara në dokumentin “Termat e Referencës”).
3. **Kalendarin e aktiviteteve**
4. **CV në gjuhën angleze** në formatin Europass

Dosja 2:

5. **Propozimin financiar**, në një zarf të mbyllur, ku të shënohet qartë “Propozimi financiar për Ekspertin 1 (emërtimi i ekspertit sipas termave të references)”

Dokumentacioni i plotë i thirrjes (përfshirë Termat e Referencës) është i disponueshëm në faqen zyrtare të AKKSHI: <https://www.nasri.gov.al/>

Për pyetje dhe më shumë detaje kontaktoni info@nasri.gov.al deri në datën 16 qershor 2025.

Agjencia Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacionin

Rruga: Naim Frashëri, nr. 37 Tiranë, Shqipëri

Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare

info@nasri.gov.al